

10/31/22, 11:52 AM

Gmail - Kthim pergjigje

2087

160/1



Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

Kthim pergjigje

Miga Xhafa <Miga.Xhafa@pp.gov.al>
To: Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

Mon, Oct 31, 2022 at 10:37 AM

I nderuar Z.Matlaja,

Në përgjigje të kërkesës tuaj, regjistruar pranë nesh me Nr.5674-R Prot. të datës 17.10.2022, lidhur me informacionin e kërkuar për shtetasin:

- Dhimitër Papa, ju bejmë me dije se:

Nga verifikimi i kryer në statistikat e procedimeve penale për periudhën 2020-2022, ndaj shtetasit të sipërpermendur nuk rezulton procedim penal i regjistruar në ngarkim të tij.

Nga verifikimi, rezulton që Z.Papa është i kallëzuar në çështjen penale nr.2761 të vitit 2022 për veprat penale "Falsifikimi i dokumenteve" dhe "Shpërdorimi i detyrës", por deri në këto momente nuk rezulton të jetë regjistruar emër autori në ngarkim për këtë çështje. Duke qenë se çështja vijon të jetë ende në fazën e hetimeve paraprake, nuk mund t'u jepet informacion i mëtejshëm në respektim të sekretit hetimor.

Për sa i takon procedimit penal nr.154 të vitit 2020 të Prokurorisë së Posaçme të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për të cilin me Vendimin Nr.95 të datës 22.07.2022 të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur shpalljen e moskompetences lëndore në lidhje me gjykimin e kësaj çështje dhe kalimin e kateve Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tiranë, bashkëlidhur po iu dërgojmë një kopje të anonimizuar të kërkesës për gjykim.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.



Miga Xhafa

Koordinator Për Të Drejtën e Informimit

**Prokuroria Pranë Gjykatës Së Shkalles Së Parë
Tiranë**

Email: miga.xhafa@pp.gov.al

Web: www.pp.gov.al

Adresa: Rruga "Haxhi Hysen Dalli" Tiranë



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
TIRANË**

Nr. ____ Prot.

Data ____/____/2022

**K Ë R K E S Ë
PËR DËRGIMIN E ÇESHTJES PËR GJYKIM**

**GJYKATËS SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR
TIRANË**

Në përfundim të hetimit të procedimit penal nr. 154 të vitit 2020, kundër:

Të pandehurit: A. M. [redacted] i biri i A. [redacted] dhe i R. [redacted], i datëlindjes [redacted] lindur dhe banues në [redacted] me adresë banimi [redacted] mbajtës i numrit personal [redacted] me arsim të lartë, me gjendje civile [redacted] më parë; hetuar me masë sigurimi "Arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit me nr. 92, datë 04.11.2021, mbrojtur nga av. Marash Ibraj, anëtar i Dhomës së Avokatishë Tiranë.

Akuzuar: Për kryerjen e veprës penale "Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Të pandehurit: F. H. [redacted] i biri i A. [redacted] dhe i [redacted], i datëlindjes [redacted] lindur dhe banues në fshatin [redacted] mbajtës i numrit personal [redacted] me gjendje civile [redacted] më parë; hetuar me masë sigurimi "Arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit me nr. 92, datë 04.11.2021, mbrojtur nga av. Adriana Kalaja, anëtare e Dhomës së Avokatishë Tiranë.

Akuzuar: Për kryerjen e veprës penale "Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i parë i Kodit Penal.

Të pandehurit: Dh. P. [redacted], i biri i [redacted] dhe i [redacted], i datëlindjes [redacted] lindur në [redacted] dhe banues në [redacted] me adresë banimi [redacted] mbajtës i numrit personal [redacted] me arsim [redacted] me profesion inxhinier ndërtimi, me gjendje civile beqar, i padënuar më parë; hetuar me masë sigurimi "Arrest në shtëpi" parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit me nr. 92, datë 04.11.2021, mbrojtur nga av. Anton Martini, anëtar i Dhomës së Avokatishë Tiranë.

Akuzuar: Për kryerjen e veprës penale "Falsifikim i dokumenteve" parashikuar nga neni 186/3i Kodit Penal.

Të pandehurit: K. K. i biri i [redacted] dhe i [redacted] i datëlindjes [redacted] lindur në [redacted] dhe banues në [redacted] me adresë banimi [redacted] mbajtës i numrit personal [redacted] me arsim [redacted] me profesion inxhinier, me gjendje civile [redacted] më parë; hetuar me masë sigurimi "Arrest në shtëpi" parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit me nr. 92, datë 04.11.2021, mbrojtur nga av. Thoma Miço, anëtar i Dhomës së Avokatishë Tiranë.

Akuzuar: Për kryerjen e veprës penale "Falsifikim i dokumentave" parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal.

Të pandehurit: S. K. i biri i [redacted] dhe i [redacted] i datëlindjes [redacted] lindur dhe banues në fshatin [redacted] me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Petrelë, mbajtës i numrit personal [redacted] me gjendje civile [redacted] më parë; hetuar me masë sigurimi "Detyrë për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas vendimit me nr. 92, datë 04.11.2021, mbrojtur nga av. Egla Gjini (Muzaka), anëtare e Dhomës së Avokatishë Tiranë.

Akuzuar: Për kryerjen e veprës penale "Shpërdorim detyre" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Nga aktet rezultoi se:

Prokurorinë e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. 154, të vitit 2020 për veprën penale të parashikuar nga neni 245/2, 186/3, 248 i K.Penal. Rezulton se në datë 29.05.2020 në Drejtorinë Rajonale të SHÇBA-së Tiranë është paraqitur shtetasi F. H., lindur dhe banues në fshatin [redacted], [redacted] i cili ka kallëzuar se: ka në pronësi një bar kafe në zonën e Mulletit, në të cilin ka filluar të bëjë disa restaurime, si ndërrime pllakash etj. Pasi i ka mbaruar këto punime, në datë 17.05.2020 lokalitë e tij ka shkuar një punonjës policie me uniformë identifikuar si shtetasi me initiale "B.G", me detyrë Oficer pranë Stacionit të Policisë Parkë, i cili ka komunikuar me babain e tij në lidhje me pedanën e restauruar, por megjithatë ata i kanë treguar lejen e miratuar nga Njësia Administrative Petrelë, punonjësi i policisë i ka thënë se ata duhej ta "respektonin", duke nën kuptuar dhënien e vlerave monetare.

Mbi këtë bazë është lejuar veprimi i simuluar dhe përgjimi telefonik si i personit të kallëzuar ashtu edhe kallëzuesit F. H., i cili është vlefësuar me vendimin nr. [redacted] datë [redacted]

Kallëzimi, ka nënshkruar marveshje bashkëpunimi, duke u vënë në dispozicion të plotë të kryerjes së veprimeve hetimore simuluese, kundrejtë subjektit të kallëzuar prej tij, që është punonjës policie. Mirëpo në vijim, sipas kallëzuesit, në datë 07.06.2020, ai ka kryer thirrje kundrejt numrit të punonjësit të policisë, por ai nuk është përgjigjur, dhe i është shmangur takimeve me

të. Po kështu nga verifikimi i akteve rezulton se oficeri i policisë gjyqësore e kishte referuar rastin në prokurori.

Nga përmbajtja e përgjimeve telefonike, duke qenë se në përgjim është vënë edhe subjekti që kishte bërë kallëzimin, ka rezultuar se në vijim i pandehuri F. H. me ndërmjetësimin e kunatit të tij, të pandehurit A. M., që rezulton të jetë punonjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Përgjithshme të Objekteve, në Bashkinë Tiranë, ka kontaktuar persona të tjerë që ushtrojnë funksione publike dhe në bashkëpunim mes paleve që pas ndërtimit të pedanës, kundrejt veprimeve korruptive të ndërtoje edhe një tendë të madhe, ngjitur me murin e lokalit të tij pa marrë më parë leje nga organet kompetente, si dhe ndërtimin e një shtese kati për banim (kati II), mbi objektin ekzistues i katesh, që funksionon si njësi biznesi (lokal).

Po nga përgjimet telefonike është përfituar e dhëna se i pandehuri A. M., për shkak dhe të lidhjes familjare që ekziston mes tyre ka kryer rolin e ndërmjetësit duke ndërhyrë tek punonjësit e Institutit të Ndërtimit dhe Intutucioneve në varësi të Bashkisë Tiranë për të ndryshuar aktin e konstatimit fillestar dhe aktin e ekspertizës së thelluar për banesën e vjetër të kallëzuesit me qëllim rritjen e klasifikimit të nivelit të dëmëve, banesë që në fakt ishte prishur me parë nga IKMT-ja si pasojë e shpronësimit me kërkesë të OST-së, pasi aty ka kaluar linja e tensionit të lartë, duke e paraqitur atë si banesë të dëmtuar nga tërmeti me qëllim për të përfituar nga granditë e ri ndërtimit.

Kështu, nga ndjekja në dinamike e këtij procedimi, rezulton se në datë 18.06.2020, ora 13:44 i pandehuri F. H. posedues i nr 06 dhe i pandehuri A. M. perdonues i nr 06 kanë komunikuar me njeri - tjetrin, dhe ky i fundit i kalon në telefon, Fatjonit, një shokun e tij, me emrin "A." për ta sqaruar për situatën. I pandehuri F. H. i thotë bashkëbiseduesit se ka bërë një aplikim të parë për tërmetin, por tani janë duke i përsëritur sërish aplikimet nga fillimi. I pandehuri F. H. shprehet që njëri thoshte nuk jepet leja, tjetri thoshte t'i jepen lejet, s'e mora vesh, po i thash e dua për leje. Shtetasi F. pyetet bashkëbiseduesin "ai di gjë ç'a quhet ajo, a është treshi po dyshë, se unë tani për shtëpinë kam vetëm fotot, se shtëpia është shemb". Gjithashtu, shtetasi Fatjon shprehet se "fotot i kanë ata cunat ..., i ka juristi, ... të gjitha do ti bëj unë tha". Bashkëbiseduesi i thotë: "po pra është ajo DS-3 a DS-2", ndërsa shtetasi Fatjon i thotë: "Po, se e kam pa unë shtëpinë tha dhe çdo gjë është në rregull". Në lidhje me pedanën F. shprehet se "se me çun letrat poshtë, se e bera sikur e kisha pas pedanën, dhe e rikonstruktova nga fillimi".

Në datë 22.06.2020, ora 12:21, i pandehuri F. H. posedues i numrit telefonik celular 06 është telefonuar nga numri telefonik 06 në posedim nga i pandehuri A. H., i cili në vijim të bisedave të kryera me parë i thotë se: "Dëgjo, folë me ato për punën e lejes, tashë pati 2000 euro i dun për të nxjerrë aktin e konstatimit, dhe 3000 euro për lejen". Personi nën hetim F. e pyet: "Po lehtë të tjerë do të kërkohej?", ndërsa shtetasi A. i thotë: "As i lehtë tjetër, 5000 euro dhe të dali leja". Gjithashtu, në vijim të këtij komunikimi ndër të tjera shtetasi A. shprehet: "Se K. vëlla ke dosja që ka cu nuk ka as akt konstatimi as i lloj gjoje, kupto? Oë të dali shtëpia e pa banueshme", "Ka plasaritë kishte shkruar K. vëlla ke ajo letra që ka cu në Bashki", ndërsa shtetasi F. i thotë: "Po në rregull me ... thuaj atyne kshu, thuaj F. ka kan kërku".

Në 23.06.2020, ora 10:18 i pandehuri F. H. ka telefonuar të pandehurin A. M. të cilit i kalon në telefonin e tij personin me emrin "K.". Në këtë komunikim telefonik personi "K." i thotë F. H. "Se na me thotë F. në këtë që ka

i thotë, nëqoftesë e rregullon, ai do të bëj sipërfaqen në pasaportën e objektit të dëmtuar 120 apo 130 metra katror, dhe do ja nis sërish.

Menjëherë pas këtij komunikimi, në orën 10:21 PD, i pandehuri A. M. telefonin të pandehurit F. H., dhe i thotë se akti i konstatimit paska shkuar në Bashki, dhe nuk ndryshohet dot, pasi është protokolluar. Gjithashtu, i pandehuri A. M. i thotë të pandehurit F. H.: "Ej me K. në her, është aty? Bëjmë dot na gjë pastaj ... se ky më thotë rregullojmë dhe të IKMT-ja, që janë këto IMT-ja Tiranës, bëjmë nai shtesë plus pastaj më vonë", ndërsa i pandehuri F. H. i thotë: "Po pra se kahu më tha vet mu ky" duke nënkuptuar personin me emrin K.

Në datë 23.06.2020, ora 11:23 PD, i pandehuri A. M., ka telefonuar poseduesen e numrit telefonik celular 06. dhe e vë atë në dijeni që nesër do të vijnë të Urbanistikës për të bërë matjet e objektit tek lokali. Në orën, 01:07 MD, i pandehuri A. M. ka komunikuar sërish me poseduesen e numrit 06., të cilës i thotë që nesër ose pasnesër do të vijë topografi të bëjë matjet, ndërkohë që këta do të bëjnë gati tashi ato dy tre pozicionet e shtëpisë, që do i thonë ata, të fusim projektin edhe do haj kohën e vet sa të shqyrtohet, do firmoset direkt.

Nga përgjimet telefonike të kombinuara me raportet e vëzhgimit, rezultojnë që në datë 25.06.2020, rreth orës 14:06 min i pandehuri F. H. është konstatuar duke dalë nga lokali i tij, së bashku me një person të moshës rreth 60 vjeç (identifikuar gjatë hetimit si babai i tij, shtetasi A. H.) dhe afrohen tek automjeti i markës "Mitsubishi", me targa . brenda të cilit ndodhen tre persona. Shtetasi A. H. hipën në mjetin e sipërcituar, ndërsa i pandehuri F. H. kthehet në lokal. Automjeti lëviz në drejtim të rreth rrotullimit të Mulletit dhe ndalon pranë një sheshi të pikëtuar pranë rrethrotullimit. Personat që ndodheshin në automjet zbresin dhe konstatohet që kanë në duar disa instrumenta, me të cilat bëjnë matje topografike, në sheshin pranë rreth rrotullimit. Pasi kanë mbaruar matjet ata janë larguar.

Nga përgjimet telefonike rezultojnë se gjatë kohës, që personat e sipërcituar po kryenin matje në terren, i pandehuri A. M. ka komunikuar vazhdimisht në telefon me të atin A., të cilin e ka orientuar që mos t'i jap shumë informacion përsonave që po kryejnë matje, mos tregojë që është shpronësuar dhe ka marrë dëmshpërmbim për shtëpinë. Në vijim të këtij komunikimi i pandehuri A. M. i thotë shtetasit A.: "... edhe nëqoftë se të pvesin thujat mu ka prish shtëpia nga tërmeti thujat, kajo rruga thujat dhe e shemen fare thujat, ra me termetin thujat dhe pastaj erdhi rruga dhe na e kan shem fare thujat, që kishte me mure rrethues me të gjitha, në rregull?"

Rezultojnë që vendi në të cilin ata, kanë kryer matje topografike në terren është pikërisht vendi ku shtetasi A. H. ka patur banesën e tij të vjetër, që fillimisht ishte dëmtuar nga tërmeti i datës 26.11.2019, por që më pas i është prishur nga IMT, Bashkia Tiranë.

Nga faktet e mësipërme ngrihen dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se nga ana e të pandehurve F. H. dhe A. M. janë kryer veprime të natyrës korruptive me qëllim që të përfitojnë nga grandit i ndërtimit për të marrë leje ndërtimi për një banesë duke e paraqitur sikur kjo e fundit është prishur nga tërmeti, ku në të vertetë banesa është prishur për shkak të shpronësimit.

Për të kryer këto veprime, nga hetimi është provuar, se ata janë ndihmuar nga punonjësit e Njesisë Administrative Petrelë, ku në mënyrë direkte ka rezultuar edhe vetë administratori i njesisë Petrelë, i pandehuri S. K. Është për tu theksuar se i pandehuri S. K. është përsori që del në komunikime telefonike, lokali i të pandehurit F. H. ndodhet shumë

pranë godinës së Njësise Administrative Petrelë dhe vetë i pandehuri pranoi njohjen me të në seancë gjyqësore, ku u shpreh qartë se njihen që familje. Po ashtu nga tabulatet telefonike rezultoi se ata kanë komunikime me njëri-tjetrin.

Duke iu referuar rastit të banesës, aplikimi fillestar i A. H. përkon me dosjen me nr aplikimi [redacted], nr Prot [redacted] datë [redacted] dhe pas nxjerrjes së udhëzimeve përkatëse, praktikat janë përcjellë nga ana e Njësise Administrative Petrelë pranë Bashkisë Tiranë. Edhe pse gjatë hetimit i janë kërkuar Njësise Administrative Petrelë aplikimet e kryera për subjektin A. H., nga ana e tyre na është përcjellë praktika e datës 30.06.2020, duke mos na u vënë në dukje që për këtë subjekt është përcjellë më parë një praktikë tjetër në datën 14.04.2020. Kjo praktikë është sekuestruar.

Konkretisht, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Tiranë ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. [redacted] prot, datë [redacted] në lidhje me kërkesën e bërë nga ana jonë në lidhje me aplikimet e kryera nga shtetasi A. H., përgjigjen që i ka dërguar Njësia Administrative Petrelë, e cila ka përmendur aplikimet e kryera për këtë shtetas, duke fshehur kështu faktin e përcjelljes së aplikimit në datën 14.04.2020, por vetëm atë të datës 30.06.2020.

Ndërkohë nisur nga fakti që nga përgjimet e të pandehurve rezultonte që praktika ishte dërguar tashmë dhe ishte në Bashki, është vendosur këyryja e librit të protokollit. Nga këyryja e datës 13.10.2021 rezultoi se me shkresën me nr. [redacted] datë [redacted] nga Bashkia Tiranë janë rikthyer praktikat përkatëse për tërmetin me qëllim që ato të kryeshin sipas rregullave dhe procedurave të miratuara me vendimet përkatëse. Pranë Njësise Administrative Petrelë është rikthyer praktika përkatëse. Konkretisht, kjo praktikë referohet me nr. [redacted] prot, datë 14.04.2020. Nga përmbajtja e shkresës rezultoi se dokumentacioni i dërguar nga Njësia Petrelë përmban konkretisht shtojca A, C, certifikatë familjare, procesverbal konstatimi nga njësi një faqe, certifikatë pronësie dhe fotokopje ID. Sipas shkresës përcjellëse të kësaj praktike nuk rezultoi të jenë aktet që janë referuar më pas me shkresën tjetër, siç është akti i konstatimit i datës 01.12.2019 sipas së cilës dëmtimet janë në nivelin DS-5, akti i cili rezultoi të jetë riprodhuar më pas.

Nga përgjimet e komunikimeve rezultoi dukshëm biseda e datës 22.06.2020 ndërmjet të pandehurve F. H. dhe A. M., ku ky i fundit i referon: "Kë vëlla ke dosja që ka cu nuk ka as akt konstatimi as i Uol gjole, kuoto? Ose të dall shënia e pa banueshme", ... "Ka plasartile kishte shkruar Kë vëlla ke qio letra që ka cu në Bashki", ndërsa i pandehuri F. H. i thotë: "Po në rrugë me ... thuhet atyne kshu, thuhet F. H. kaq kan kërk".

Në rastin konkret, Njësia Administrative Petrelë nuk ka vendosur skualifikimin e subjektit duke qenë se certifikata e pronësisë ishte e vjetër dhe jo e freskët e tre muajve të fundit kërkesë kjo ligjore e detyrueshme dhe se banesa ka qenë e prishur nga IMT-ja.

Po kështu personat kanë nisur edhe kryerjen e veprimeve për të bërë pasaportën që është pikërisht gjenplani që realizohet për efekt të lejes së ndërtimit, ndryshe nga sa u pretendua në seancë nga administratori se ishin për nevojat të projekteve që Bashkia Tiranë kishte me Bashkimin Evropian.

Në 23.06.2020, ora 10:18 i pandehuri F. H. ka telefonuar të pandehurin A. M., të cilit i kalon në telefonin e tij personin me emrin "Kë". Në këtë komunikim telefonik personi me emrin "Kë" i thotë të pandehurit A. M. "Se po me thotë F. H. për këtë që ka dalë për 93", ... "Po kjo në bazë të pasaportës që kemi prur ne, apo certifikatës? Se po të duket ta ndryshojmë në sipërfaqen këtu ke pasaporta që kemi cu ne këtu te tonat, tja çojme 120 - 130. Gjithashtu ata diskutojnë për sipërfaqen e objektit që mund të jetë shënuar në aktin e konstatimit të përgatitur nga Instituti i Ndërtimit, ku i pandehuri A. M. shprehet se akti i konstatimit nuk është problem, pasi këtë dokument mund ta rregullojë ai prap, ndërsa personi me emrin Kë

i thetë, nëqoftëse e rregullon, ai do të bëjë sipërfaqen në pasaportën e objektit të dëmtuar 120 apo 130 metra katror, dhe do ja nis sërish.

Pra në rastin konkret Njësia Administrative Petrelë ka fshehur këtë fakt duke mos përmendur praktikën e dërguar në muajin prill të vitit 2020 e cila nuk është lajthitje apo lapsus dhe praktika që është dërguar në datën 30.06.2020 rezultoi të jetë bërë qëllimisht në atë formë, nisur nga dyshimet që administratori ka patur për hetimet që po kryeshin, fakt për të cilin ka vënë në dijeni edhe punonjësit e Bashkisë.

Dëmet e banesave ishin të përcaktuara nga aktet e konstatimit të mbajtura nga vetë përfaqësuesit e Njësise Administrative Petrelë. Ndërkohë që urdhri i brendshëm i Institutit të Ndërtimit për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e akt ekspertizave për objektet e ndërtura ka dalë në datën [redacted] dhe mban Nr. [redacted] prot. Në këtë grup janë përfshirë të pandehurit Dh. [redacted] P. [redacted] dhe K. [redacted] K. [redacted]. Sipas urdhrat, ata duhet të fillojnë punën me inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve të objekteve të Bashkisë Tiranë.

Mbështetur në argumentat e mësipërme, rrjedhimisht rezultoi i pavend dhe i pambështetur në ligj pretendimi i ngritur nga i pandehuri S. [redacted] K. [redacted]

Gjithashtu, në praktikën e përpiluar nga Njësia Administrative Petrelë për rastin e shtetasit A. [redacted] H. [redacted] ekziston një Realacion i prodhuar nga ana e Njësise Administrative Petrelë, i firmosur nga titullari i saj, shtetasi S. [redacted] K. [redacted], i cili sqaron situatën e rastit konkret. Vlen të theksohet se ky dokument zyrtar i prodhuar nga një institucion publik siç është Njësia Administrative Petrelë janë në shkelje të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat", Vendimit Nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë", si dhe të Normave Teknike-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë:

Neni 13 Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhrat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e jashtetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës "në përgjigje" ose "në vijim të shkresës". Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar. Mungesa e datës dhe protokollimit të këtij Relacioni, ngre dyshime se nga ana e Njësise Administrative Petrelë nuk janë zbatuar procedurat standarte përse i përket rastit të shtetasit A. [redacted] H. [redacted].

Gjithashtu, në deklarinimin që ka dhënë në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, shtetasi B. [redacted] C. [redacted], i cili është personi në fotografinë afishuar Akt Ekspertizës së Thelluar për banesën e shtetasit A. [redacted] H. [redacted], të përpiluar nga i pandehuri Dh. [redacted] P. [redacted] shprehet se: "...Mbaj mend që tek shtëpia e shtetasit A. [redacted] H. [redacted] kam qenë gjithsej dy herë. Një herë kam qenë me dy kolegë të mi të Njësise Administrative Petrelë, A. [redacted] H. [redacted] dhe një person tjetër i cili për momentin nuk më kujtohet. Herën e dytë, së bashku me A. [redacted] H. [redacted] kemi qenë me dy inxhinierë të Institutit të Ndërtimit, njëra prej të cilave quhej M. [redacted].... Nuk kam qenë kurrë në terren me shtetasin Dh. [redacted] P. [redacted]."

Sipas Akti Nr. [redacted] Ekspertim Teknik - Kompjuterik, datë [redacted], i cili ka nxjerrë rezultatet e ekspertimit kompjuterik të kryer në kompjuterin i cili është sekuestruar shtetasit Dh. [redacted] P. [redacted], [redacted] në ekspertim apo

krijohet një folder me emërtimin "A H", pastaj brenda tij krijohen dy foldera me emrat "A H 26.11.2019" dhe "A H shtetori". Nga analizi i aktivitetit të kompjuterik objekti ekspertimi konstatohet se përdoruesi i këtij kompjuteri e ka ndryshuar disa herë datën dhe orën e kompjuterit duke e lëvizur atë përpara ose mbrapa me muaj dhe vite. I pandehuri D H F është i kontraktuar nëpërmjet marrëveshjes së lartpërmendur dhe ndryshe nga sa ai pretendoi, ai nuk ka qene pjesë e ekipeve dhe nuk rezultojnë të ketë kryer asnjë veprim konstatues më parë në lidhje me këtë banesë. Pretendimi i tij se ai e ka parë banesën dhe i kishte të ruajtura fotografite në janar të vitit 2020 nuk qëndron.

Referuar komunikimeve të datës 22.06.2020, ora 12:21, i pandehuri F H posedues i numrit telefonik celular 06 është telefonuar nga numri telefonik 06 në posedim nga i pandehuri A H, i cili në vijim të bisedave të kryera me parë i thotë se: "Dërgo foli me ato për punën e lejes, tashi rati 2000 euro i dun për të nxirre aktin e konstatimit, dhe 3000 euro për lejen". Personi nën hetim F e pyet: "Po lehtë të tjera do kërkohet?", ndërsa shtetasi A i thotë: "As i lehtë tjetër, 5000 euro dhe të dali leja. Gjithashtu, në vijim të këtij komunikimi ndër të tjera shtetasi Arlind shprehet: "Se K vëlla ke dasia që ka cu nuk ka as akt konstatimi as i lloj xhole, kuptoj. O të dali shtëpia e pa banueshme"... "Ka plasaritje kishte shkruar K vëlla ke alo letra që ka cu në Bashki", ndërsa shtetasi F i thotë: "Po në rregull me... thuaj atyne kshu, thuaj F kaa kan kërkua..."

Nga ky komunikim del dukshëm që në rastin konkret nga ana e Njesisë Administrative Petrelë është referuar më parë praktika për subjektin A H dhe në praktiken e dërguar rezultojnë se banesa ka plasaritje dhe që duhej një akt që ta nxirrte banesën të pabanueshme. Për këtë arsye rezultojnë të jete paguar shuma prej dy mijë euro për të kryer aktin e ekspertizës së thelluar, akti i cili është kryer në datën 22.06.2021 ora 21:46 nga ana e ekspertit të pandehur D H P. Pavarësisht se në aktin e ekspertizës shkruhet data 16.05.2020, vula elektronike tregon kohën e duhur të nënshkrimit të aktit që është pikërisht data që përkon edhe me bisedën. Në këtë akt përcaktohet qartë se ndërtesa objekti ekspertimi konsiderohet se ka dëme të theksuara në strukturë, me rrezik shumë të lartë për dëmtimin e shëndetit dhe humbjen e jetës së njerëzve, e papërdorshme duke rekomanduar prishjen e saj dhe ndërtimin e një ndërtese të re. Pretendimi i të pandehurit D H P se ai e ka parë më parë banesën nuk qëndron. Ai vetë pranoi në seancë gjyqore se i ka takuar të pandehurit pasi është thirrur për tu pyetur dhe pikërisht pas paraqitjes pas herës së parë ka paraqitur fotografite përkatëse në policinë gjyqore, me qëllim për të justifikuar aktin. Ndërkohë që dhe vetë fotografite e paraqitura tregojnë vetëm plasaritje në dukje.

Në rastin konkret rezultojnë dukshëm që eksperti që ka për detyrë të bëjë vlerësim të thelluar në vend, të gjendjes siç e ka dhe emrin akti i ekspertimit, kryen një akt dhe bën vlerësime për një banesë që nuk ka ekzistuar në kohën e kryerjes së këtij akti. Ai ka konsumuar tërësisht elementët e veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave" parashikuar nga neni 186/3 të Kodit Penal. Për sa i përket të pandehurit S K ashtu siç është theksuar edhe në senacën gjyqore nga ana e prokurorisë ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se ai ka kryer veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Nga provat e marra rezultojnë se i pandehuri F H njofton Njësine se do të bëjë restaurime të pedanës së lokalit, për një pedanë të cilën ai e ka bërë nga e para në një lokal që është ngjitur me Njësine Administrative Petrelë dhe i pandehuri, pranuar prej vetë tij ka njohje të hershme me të pandehurin F H. Kjo provohet pasi ai komunikojnë edhe nga telefoni i tij për të zgjidhur problemet për banesën për ta bërë 120-130 m dhe jo 93 dhe për shkak të këtyre rrethanave ai nuk mund të mos dinte që pedana kishte ekzistuar më parë por është ribërë nga e para. Po ashtu nuk mund të mos kishte dijeni se banesa i ishte prishur nga IMT-ja. Nga prokuroria janë sekuestruar

libri i protokollit të korrespondencës si dhe njëra qendrore e kompjuterit të kësaj njësie, past ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova që aktet për subjektin A. H. janë ribërë nga e para, kur në një moment të caktuar të hetimit për të cilin po kryhen verifikimet përkatëse, ai ndryshoi mendje në lidhje me aplikimin e bërë nga subjekti A. H., duke iu bërë me dije edhe personave të tjerë punonjës në Bashki në lidhje me këtë situatë. Ai edhe pse ka patur dijeni për bazeën, nuk ka bërë vetë skualifikimin e subjektit sic ka vepruar me raste të tjera, për shembull rastin H. C., i cili është skualifikuar, por e ka përfjellë këtë praktikë pranë Bashkisë Tiranë. Me veprimet e kryera ai tregon për rrezikshmëri dhe vë në rrezik provat që duhet të sigurohen gjatë hetimit në lidhje me Njësinë Administrative Petrelë.

Analiza ligjore neni 245/1 i K.Penal

Neni 245/1 i K.Penal, parashikon si vepër penale "Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i dytë i Kodit Penal. Sipas kësaj dispozite:

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që premion ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dështruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dështruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet

Qëllimi i kësaj dispozite mesa shihet është që të godasë aktivitetin e korrupsionit që kryhet në këmbim të favoreve apo përfitimeve.

Në bazë të Konventës Penale për Korrupsionin, ratifikuar me ligjin nr. Nr.8778, datë 26.4.2001, në n. 3 është parashikuar korrupsioni pasiv i zyrtarëve publikë kombëtarë, në një thirrje për shtetet palë. Konkretisht kjo dispozitë parashikon:

"Secila Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale, sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim kërkimin ose marrjen nga cilido prej zyrtarëve publikë të asaj Pale, direkt ose indirekt, të çfarëdoqavantazhi që nuk i takon, për vete ose për të tjerë, ose pranimi i një oferte ose premtimi apo avantazhi të tillë, për të vepruar ose mosvepruar në ushtrim të funksioneve të tij/saj"

Në bazë të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, ratifikuar me ligjin nr. 9492 datë 13.03.2006, rezulton se në n. 15 i bëhet thirrje shteteve palë që:

"Secili shtet palë miraton ato masa legislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për parashikimin si vepra penale, kur kryhet me qëllim:

a) premtimi, ofrimi ose dhënia një nëpunësi publik, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i një avantazhi të parregullt për vetë nëpunësin ose një person tjetër apo subjekt, me qëllim që nëpunësi të veprojë ose të mos veprojë në ushtrim të funksioneve të tij ose të saj zyrtare.

b) kërkimi ose pranimi nga nëpunësi publik, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i një avantazhi të parregullt për vetë nëpunësin ose një person tjetër, apo një subjekt, me qëllim që nëpunësi të veprojë ose të mos veprojë në ushtrim të funksioneve të tij zyrtare."

Në analizën më lart u parashtrua, se shtetasi A. H. dhe F. H. të ndërgjegjshëm për veprimet e kryera kanë konsumuar të gjithë elementët e veprës penale për të cilën organi i akuzës ka marrë në mënyrë të drejtëpërdrejtë të gjitha veprimet për zbardhjen e plote të çështjes. Ky veprim konsiderohet i provuar plotësisht nga provat e grumbulluara për efekt të këtij procedimi.

Analiza ligjore neni 248 i K.Penal

Neni 248 i K.Penal, ndryshuar me ligjin nr. 9275 datë 16.09.2004, neni 21, "Shpërdorimi i detyrës" parashikon:

"Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjetër përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridik, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet."

Nga ana objektive kjo veprë penale është konsumuar nëpërmjet mosveprimit të shtetasit Soko Kupi, siç është provuar me kërkimi i një veprimi në kundërshtim me ligjin.

Lidhja shkakësore e veprimeve të të pandehurit S. K., me pasojën e ardhur është e drejtëpërdrejtë. Nëse i pandehuri S. K., do të kishte kryer detyrën e tij sipas kërkesave të ligjit, i pandehuri S. në rradhë të parë do të kishte mësuar se në të vërtetë të pandehurit F. nuk i takonte të kryente proceduarat për demin që pretendohet se ishte shkaktuar.

Gjithbashtu, duke pasur parasysh formulimin e nenit të mësipërm vërejmë se pasoja që kërkohet të vijë është "dëmtimi i interesave të ligjshme". Ky nen nuk përcakton që pasoja duhet të jetë në pasuri apo të ketë ndonjë përcaktim të kufizuar. Arsyeja që legjislatori e ka lënë të hapur këtë pjesë të dispozitës, nënkupton që interesi i cili i dëmtohet personit është i shumëllojshëm, duke u parë rast pas rastit. De facto paratë janë dhënë më përpara se të përpilohej akti dhe de jure, ky veprim i tyre është formalizuar në momentin që kanë dërguar aktet.

Në analizën më lart u parashtrua, se shtetasi S. K. duke qenë i ndërgjegjshëm për veprimet e kryera kanë konsumuar të gjithë elementët e veprës penale për të cilën organi i akuzës ka marrë në mënyrë të drejtëpërdrejtë të gjitha veprimet për zbardhjen e plote të çështjes. Ky veprim konsiderohet i provuar plotësisht nga provat e grumbulluara për efekt të këtij procedimi.

Analiza ligjore neni 186/3 i K.Penal

Neni 186/3 i Kodit Penal parashikon se "Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet.

Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet."

Nga sa më lart, rezultoi se nga ana e të pandehurit Dh. P. dhe K. K., është falsifikuar një akt nga ana e tyre i cili është dërguar me qëllim për tu përdorur nga i pandehuri F. për të përfituar nga Granti i Rindërtimit për pasojat e shkaktuara nga tërmeti i nëntorit 2019. Pra, nisur nga fakti se këta persona kanë krijuar besim mes tyre ata kanë patur komunikime e krahas faktit që kanë lënë të pandehurit A. M. dhe F. H. duke premtuar/kërkuar

persona që ushtrojnë funksione publike, në rastin konkret për të përfituar nga Granti i Rindërtimit për pasojat e shkaktuara nga tërmeti i nëntorit 2019.

Të pandehurit D. P. dhe K. në përpilimin e dokumentit Akt i Ekspertizës së Thelluar, kanë paraqitur rrethana të rreme të gjendjes së objektit në momentin e përpilimit të aktit, krahasuar me gjendjen faktike të tij në kohën e përpilimit të këtij akti.

I pandehurit S. K. me anë të veprimeve të kryera nga ana e tij për të pasqyruar një situatë jo reale nga ajo që faktikisht ishte në rastin e shtetasit A. H. duke i krijuar këtij të fundit hapsira ligjore për të përfituar nga granti i Rindërtimit, për të cilin në fakt nuk i takonte ligjërisht. Nga provat e analizuar në detaje, këto akuza rezultojnë të provuara nga tërësia e akteve, provave të marra e të verifikuara gjatë hetimeve në këtë proces penal, pasqyruar hollësisht si më poshtë,

Rezultatet e përgjimit të komunikimit ndërmjet tyre, procesverbal i transkripteve të datave 18.6.2020, 21.6.2020, 22.6.2020, 23.6.2020, 25.6.2020 e të tjera, raport vëzhgimi datë 25.6.2020, etj.;

Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale (R. K. A. H. A. Q. B. G. D. P. A. S. etj.), si dhe Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime (F. H. A. M. S. K.); Procesverbal Kqyrje/marrje i provës materiale, datë 18.10.2021; Procesverbal për kqyrjen e të dhënave kompjuterike datë 11.6.2021; Procesverbal për kqyrjen e të dhënave kompjuterike datë 23.6.2021; Procesverbal për kqyrjen e të dhënave kompjuterike datë 5.7.2021; Procesverbal për kqyrjen e të dhënave kompjuterike datë 5.7.2021; Procesverbal për kqyrjen e të dhënave kompjuterike datë 18.7.2021; Procesverbal për sekuestrimin e sendeve, datë 10.9.2021 (Praktika e aplikimit të shtetasit A. H.); Procesverbal për kqyrjen dhe marrjen e provës materiale, datë 26.11.2021 (Libër Protokolli, Bashkia Tiranë); Procesverbal për kqyrjen dhe marrjen e provës materiale, datë 2.12.2021 (Libër Protokolli, Bashkia Tiranë); Procesverbale mbi ekzekutimin e vendimit penal, datë 5.11.2021, proces verbal kontrolli date 5.11.2021, Procesverbal sekuestrim i provës materiale datë 5.11.2021, shkresa Nr. prot. Datë 24.8.2021, nga Drejtoria Kadastrës, Bashkia Tiranë; shkresa Nr. prot. Datë 10.09.2021, nga IMT Bashkia Tiranë; shkresa Nr. 33050/5 Prot, datë 22.09.2021 nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Bashkia Tiranë; shkresa Nr. datë 10.8.2021 nga ASHK Rurale I, shkresa Nr. datë 24.9.2021 nga ASHK Rurale I; shkresa Nr. datë 27.7.2021 nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Bashkia Tiranë; Dosja Nr. Aplikimi dhe Nr. Protokoll, datë 27/02/2020, në emër të aplikantit A. H.; Shkresat nga kompanitë telefonike si Nr. datë 13.07.2021, nga Kompania telefonike One Telecommunications, datë 28.6.2021 nga kompania telefonike Vodafone, etj., Akti Nr. Ekspertim Teknik – telefoni celular dhe kartash SIM, datë 17.03.2022, Akti Nr. Ekspertim Teknik – telefoni celular dhe karte SIM, datë 17.03.2022, Akti Nr. Ekspertim Teknik – Kompjuterik, datë 01.04.2022, si dhe akte të tjera hetimore;

Si dhe gjithë aktet e tjera të përfshira në fashikullin e procedimit penal.

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 331 të K. Pr. Penale,



KËRKUJ

Dërgimin për gjykim të çështjes nr. 154 të vitit 2020, me të pandehur:

1. A. M., i biri i [REDACTED] dhe i [REDACTED] i datëlindjes [REDACTED], lindur dhe banues në [REDACTED], me adresë banimi [REDACTED] mbajtës i numrit personal [REDACTED]

Akuzuar: për kryerjen e veprës penale "Ushttrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i dytë i Kodit Penal.

2. F. H., i biri i [REDACTED] dhe i [REDACTED], i datëlindjes [REDACTED] lindur dhe banues në fshatin [REDACTED] mbajtës i numrit personal [REDACTED]

Akuzuar: për kryerjen e veprës penale "Ushttrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i parë i Kodit Penal.

3. D. P., i biri i [REDACTED] dhe i [REDACTED] i datëlindjes [REDACTED] lindur në [REDACTED] dhe banues në [REDACTED] mbajtës i numrit personal [REDACTED]

Akuzuar: për kryerjen e veprës penale "Falsifikim i dokumentave" parashikuar nga neni 186/31 Kodit Penal.

4. K. K., i biri i [REDACTED] dhe i [REDACTED] i datëlindjes [REDACTED] lindur në [REDACTED] dhe banues në [REDACTED] mbajtës i numrit personal [REDACTED]

Akuzuar: për kryerjen e veprës penale "Falsifikim i dokumentave" parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal.

5. S. K., i biri i [REDACTED] dhe i [REDACTED] i datëlindjes [REDACTED] lindur dhe banues në fshatin [REDACTED] me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Petrelë, mbajtës i numrit personal [REDACTED]

Akuzuar: për kryerjen e veprës penale "Shpërdorim detyre" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

PROKURORI

Elvin GOKAJ